



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:076922

Datë: 28.04.2019

Numri i dokumentit: 00293592

P.nr.51/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, Departamenti i përgjithshem penal, gjyqtari Sulltan Dobraj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër të pandehurit R. TH. për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 e lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Peja PP/II.nr.96/2019 te dt.20.02.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt.**19.03.2019**, me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Lumturije Vuqetaj, dhe të akuzuarit, me dt. 19.03.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. **11.04.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R. TH., i lindur me dt....., i biri i S. dhe nënës SH. e gjinisë L., me nr. personal shqiptar, shtetas i Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se :

Më dt.25.12.2018 reth orës 14:45 min. nga pakujdesia duke e shkel ligjin mbi komunikacionin rrugor nga neni 54 par.1 nënpar.1.2 të ligjit, gjatë qarkullimit duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme mes mjeteve, shkakton aksident komunikacioni me dëme materiale dhe lëndime trupore të dëmtuarit I. B. në atë mënyrë që ditën kritike derisa i pandehuri drejton veturën VW Caddy me targa ..., para ti e në të njëjtin drejtim ishte duke qarkulluar edhe i dëmtuari me veturën Golf II me targa ... dhe me të arritur tek shtëpia e S. D., i dëmtuari e ngadalëson shpejtësinë me qëllim të ndaljes dhe i pandehuri për shkak të mos mbajtjes së distancës së mjaftueshme mes mjeteve nuk arrin ta ndaloj veturën e ti dhe me pjesën e përparme ballore e godet në pjesën e pasme veturën e të dëmtuarit duke shkakuar aksident dhe me këtë rast përveç dëmeve materiale në vetura, lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës ka pësuar i dëmtuari I. B..

- **me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 e lidhur me par.6 te KPRK- së.**

Andaj gjykata, ne bazë të nenit 17, 41, 45, 50, 51, 52, 73, 74, nenit 378 par. 1 lidhur me par 8 të KPRK-ës, nenit 365, 453, 463 par 2 të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

GJYKON ME DËNIM ME KUSHT

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, i cili dënim nuk ka për tu ekzekutuar fare nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale në afat prej një 1 (një) viti.
- II. I dëmtuari I. B. nga fsh. Irzniq k-Deçan udhëzohet në kontest civil për realizim e kërkesës pasurore juridike
- III. I pandehuri lirohet nga shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën PP/II.nr.96/19 të dt.20.02.2019 ka akuzuar R. TH.n për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 e lidhur me par.6 të KPRK- së. ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata Themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt.19.03.2019 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal të shqyrtimit fillestar në bazë të nenit 248 të KPPRK-ës.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar: Meqenëse i pandehuri e pranon fajësinë e ky pranim i fajësisë mbështetet me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë në tërësi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik të saj gjykatës i propozoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe ta dënohet sipas ligjit, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese të merre pranimin e fajësisë.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: shprehi keqardhje, jam shumë i penduar, premtoj që në të ardhmen do të jam më i kujdesshëm në vozitje.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se më dt. 25.12.2018 rreth orës 14:45 min. Në rrugën nga pakujdesia duke e shkel ligjin mbi komunikacionin rrugor nga neni 54 par.1 nënpar.1.2 të ligjit, gjatë qarkullimit duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme mes mjeteve, shkakton aksident komunikacioni me dëme materiale dhe

lëndime trupore të dëmtuarit I. B. në atë mënyrë që ditën kritike derisa i pandehuri drejton veturën VW Caddy me targa ..., para ti e në të njëjtin drejtim ishte duke qarkulluar edhe i dëmtuari me veturën Golf II me targa ... dhe me të arritur tek shtëpia e S. D., i dëmtuari e ngadalëson shpejtësinë me qëllim të ndaljes dhe i pandehuri për shkak të mos mbajtjes së distancës së mjaftueshme mes mjeteve nuk arrin ta ndalojë veturën e ti dhe me pjesën e përparme ballore e godet në pjesën e pasme veturën e të dëmtuarit duke shkaktuar aksident dhe me këtë rast përveç dëmeve materiale në vetura, lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës ka pësuar i dëmtuari I. B..

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprën penale te lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do te këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne bazë te nenit 257 te KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri

e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë në bazë te nenit 248 te KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bere ne mënyre vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te pandehurit janë formuar te gjitha elementet e figurës se veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 te KPRK-ës, ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këtë vepër penale, i pandehuri i ka kuptuar veprimet e tija, por nuk e ka dashur pasojën e shkaktuar, ka vendosur dhe te pandehurin e ka shpall fajtor për këtë vepër penale, i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, te cilat mund te ndikojnë ne lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj te pandehurit.

Gjykata ne baze te nenit 73 te KPK si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljet e mira gjatë gjykimit, pastaj kërkim falja nga ana e te pandehurit, premtimi i te pandehurit se ne te ardhmen do te jetë i kujdesshëm, ka qenë hera e parë e tij që ka shkaktuar një vepër penale, mosha e te pandehurit ku deri ne ketë moshe nuk ka pasur asnjë vepër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata në bazë të nenit 41 të KPK rastin e shqiptimit të dënimit ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe se do të arrihet qëllimi i dënimit, do të parandalohet pandehuri nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalohet personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqërorë për veprën penale ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK të dëmtuarin I. B. nga Irzniqi K-Deçan, e ka udhëzuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike sepse nuk ka pasur në shkresat e lëndës një kërkesë pasurore juridike të specifikuar .

Gjykata në bazë të nenit 454 të KPPK të pandehurin e lirion nga shpenzimet e procedurës penale sepse ka konsideruar se i pandehuri është i gjendjes së dobët ekonomike.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.51/2019 të dt. 11.04.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e marrjes, drejtuar gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:076922
Datë: 28.04.2019
Numri i dokumentit: 00293592